



FTESË PËR APLIKIM TË GRANTEVE PËR TË RIATDHESUARIT NË ZONAT RURALE NË KOMUNËN E DRENASIT

Pëshkrimi i projektit:

Organizata joqeveritare "Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës" – IADK është duke zbatuar projektin "Përfshirja ekonomike e të riatdhesuarve përmes bujqësisë në zonat rurale dhe ngritja e kapaciteteve përmes formimit profesional" në komunat: Rahovec, Malishevë, Drenas, Skenderaj, Klinë, përkrahur nga donatori GIZ nga Gjermania.

Qëllimi i projektit është gjenerimi i të ardhurave dhe trajnimi i të riatdhesuarve dhe familjeve në zonat rurale. Projekti do të trajtoj papunësin, duke i targetuar të riatdhesuarit, gratë, minoritetet dhe personat me aftësi të kufizuara. Projekti ka për qëllim të krijoj kushte për aktivitete bujqësore apo biznese, të cilat mundësojnë krijimin e të hyrave dhe përmisojnë gjendjen socio-ekonomike të popullatës në zonat rurale ku do të ketë shtrirje ky projekt.

Në këtë projekt do të shpërndahen grante me fokus të veçantë në **pemtari, perimtori, përpunim të ushqimit dhe blegtori**.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të riatdhesuarit që kanë gjendje të rëndë ekonomike, e posedojnë parakushte për t'u marr me bujqësi,
- Të riatdhesuarit të cilët nuk janë përkrahur më parë me ndonjë projekt nga qeveria, komuna apo ndonjë donator tjerë.
- Të riatdhesuarit të cilët kanë ide për të filluar apo zgjeruar kapacitetet prodhuese që gjenerojnë të ardhura afatgjate në ekonominë familjare.
- Përparësi do të kenë personat e riatdhesuar dhe familjet e tjera në nevojë nga zonat rurale me gjendje më të rëndë ekonomike.

Kandidatët e interesuar mund t'i marrin aplikacionet gjatë mbajtjes së sesioneve informuese, që do të mbahet me datën **23/11/2018** në sallën e Kuvendit të Komunës së Drenasit nga ora **10.00** apo në zyrën komunale për kthim dhe riatdhesim, webfaqen e Komunës së Drenasit, webfaqen e IADK-së (<http://www.iadk.org>) dhe në Facebook të IADK-së.

Vërejtje: Aplikacionet duhet t'i dorëzoni brenda afatit kohor deri me **7 dhjetor 2018**

Për informata shtesë mund të kontaktoni në këta numra kontaktues: **+383 (0) 44 777 036** ose **+383 (0) 49 777 046**

Sinqerisht

Zenel Bunjaku

Drejtor Ekzekutiv i IADK-së



Perkrahur nga :

